



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:124136

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06024615

**2023:124137**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.30/24 të datës 05.08.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit, J.B nga Kaçaniku me mbrojtësin me autorizim av. N. R dhe mbrojtësit të të dëmtuarit, av.D. R , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.590/23 të dt. 26.05.2023, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 06.08.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.30/24 e datës 05.08.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit J.B nga Kaçaniku me mbrojtësin me autorizim av. N. R dhe mbrojtësit të të dëmtuarit, av.D. R.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.590/23 e dt. 26.05.2023 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit J.B nga Kaçaniku, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.590/23 të dt. 26.05.2023, e ka akuzuar të pandehurin J.B nga Kaçaniku, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 05.08.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:124137, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 05.08.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.30/24, në mes palëve në procedurë, dhe atë të pandehurit J.B nga Kaçaniku, me mbrojtësin me autorizim av. N. R dhe mbrojtësit të të dëmtuarit, av.D. R.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023:124137 datë 06.08.2024**

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.